

Vlorë, me 28/12/2020

## PLATFÖRMË

### PËR KANDIDIMIN NË POZICIONIN E ANËTARIT TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Këshilli i Lartë i Prokurorisë është një organ kushtetues, i ngarkuar me përgjegjësinë për të garantuar pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë erdhi si pasojë e nevojës së reformimit tërësor të sistemit të prokurorisë, dhe qëllim kryesor ka garantimin e pavarësisë dhe ofrimin e garancive efektive për prokurorët në ushtrimin e detyrës së tyre.

Sfida me të cilën përballet i gjithë sistemi i prokurorisë në ditët e sotme, është fitimi i besimit të publikut, mungesa e të cilit u bë shkak për reformimin e të gjithë sistemit të drejtësisë. Fitimi i besimit të publikut te prokuroria kërkon domosdoshmërisht ekzistencën e një prokurorie efektive, transparente dhe që lufton në mënyrë të dukshme e të ndjeshme kriminalitetin. Si një organ relativisht i ri, Këshilli me vendimmarrjet e tij veç besimit të publikut, është përballur me sfidën e fitimit të besimit të prokurorëve te një sistem prokurorie funksional dhe efektiv.


Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka rol përcaktues në krijimin e një sistemi efektiv, që garanton pavarësinë, llogaridhënien dhe karrierën e prokurorëve, me anë të vendimmarrjeve transparente dhe të bazuara në meritokraci.

Kjo platformë shpreh pikëpamjet e mia mbi rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë si dhe objektivat personale si kandidat për anëtar në këtë Këshill.

#### I. Objektivat

Në nenin 149 të Kushtetutës përcaktohet se Këshilli i Lartë i Prokurorisë garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë. Ndërkohë në nenin 149/a parashikohet se Këshilli ushtron këto përgjegjësi:

- emëron, vlerëson, ngrë në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve;
- vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve;
- i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, sipas ligjit;
- miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre;
- propozon dhe administron buxhetin e tij;
- informon publikun dhe Kuvendin mbi gjendjen e prokurorisë;
- ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.



Nga sa më lart, rezulton se përgjegjësia kryesore kushtetuese e Këshillit të Lartë të Prokurorisë lidhet me administrimin e sistemit të karrierës së prokurorëve. Në përbushje të kësaj përgjegjësie, Këshilli ka miratuar rregulloret përkatëse, konkretisht me Vendimin nr. 200, datë 23/09/2020, të KLP, është miratuar Rregullorja "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksonit të përgjithshëm". Ndërsa me Vendimin nr.261, datë 17/11/2020 të KLP është miratuar rregullorja "Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së levizjes paralele".

Pas miratimit të këtyre rregulloreve e njëkohësisht krijimit të kuadrit ligor të nevojshëm për kryerjen e levizjeve në prokurori, është detyrë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë që përmes procedurave transparente dhe të bazuara në meritokraci të nxise kurajon profesionale të prokurorëve me qëllim ndërtimin e një sistemi funksional karriere. Realizimi me sukses i këtij detyrimi ligor do të passjellë përbushjen e sfidës kryesore të Këshillit, që është fitimi i besimit të prokurorëve të vetë sistemi, e më tej krijimin e besimit të publikut te prokurorët.

Në cilësinë e kandidatit për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, vlerësoj si objektiva kryesore në të cilat do të përqëndroj angazhimin tim, si më poshtë vijon:

- Krijimin e një sistemi karriere transparent dhe të bazuar në meritokraci;
- Garantimin e qëndrueshmërisë në detyrë, përfshirë këtu edhe transferimin që mund të kryhet vetëm sipas ligjit dhe pas dhënies së pëlqimit;
- Krijimi i një sistemi prokurorie të pavarur, duke garantuar pavarësi reale të prokurorëve;
- Konsolidimin e garancive të statusit të prokurorit, përgjegjësisë dhe llogaridhënieve në funksionin e detyrës;

Në lidhje me krijimin e një sistemi karriere transparent dhe të bazuar në meritokraci, vlerësoj se përveç kuadrit ligor të hartuar dhe të miratuar, është e nevojshme që prokurorët të kenë besim se procedurat e promovimit apo të transferimit të tyre në sistemin e prokurorisë do të jenë të rregulla, transparente dhe që nxisin konkurrencë reale mes kandidatëve. Me qëllim realizimin e këtij objektivi nevojitet që prokurorët të kenë akses në të dhënat mbi të cilat Këshilli bazon vendimmarrjen përsa i përket procedurave lidhur me karrierën e prokurorëve. Kështu, me qëllim fitimin e besimit të prokurorëve është e nevojshme që ata të perceptojnë që vendimmarrja e Këshillit lidhur me karrierën e tyre bazohet në parimin e meritokracisë, në integritetin profesional e personal të gjithësecilit si dhe që vlerësim i këtyre elementeve bëhet duke marrë në konsideratë kritere objektive.

Një element i rëndësishëm i karrierës është qëndrueshmëria në detyrë (në pozicion). Për realizimin e këtij elementi Këshilli duhet që në çdo rast të marrë në konsideratë vullnetin e prokurorit për t'u transferuar, pavarësisht përiudhës së transferimit/caktimit, përveç rasteve kur është objektivisht e pamundur të veprohet ndryshe.

Gjithashtu, Këshilli luan një rol të rëndësishëm në krijimin e një sistemi prokurorie të pavarur, ku prokurorët gjëzojnë pavarësi reale në ushtrimin e detyrës së tyre. Ky rol i Këshillit, bëhet me i dukshëm në kompetencën që i është dhënë për shqyrtimin e ankimeve të prokurorëve lidhur me paligjshmërinë apo pabazueshmërinë e udhëzimeve të përgjithshme të prokurorëve më të lartë<sup>1</sup> si dhe në shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimit të Drejtuesit të Prokurorisë për zëvendësimin e prokurorit.<sup>2</sup>


## II. Mekanizmat për realizimin e objektivave

Me qëllim realizimin e objektivave të sipërlistuara, në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë do angazhohem për parashtrimin e ideve të qarta e konkrete në funksion të marrjes së masave për realizimin e detyrave ligjore, përmes:

- Ofrimit të eksperiencës personale për hartimin e planifikimit strategjik të sistemit të prokurorisë si dhe të akteve nënligjore në kompetencë të Këshillit;
- Propozimin për krijimin e një sistemi pikëzimi me qëllim kryerjen e vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve bazuar në kritere objektive;
- Propozimin e publikimit në faqen e Këshillit të relacioneve lidhur me vlerësimin e prokurorëve që kandidojnë për pozicione të ndryshme përmes procedurës së ngritjes në detyrë/transferimit;
- Propozimit për shqyrtimin e ankimeve ndaj udhëzimeve, vendimeve të zëvendësimit apo kërkesave të tjera lidhur me pretendimet për cënim pavarësie të prokurorëve drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në praninë e prokurorit që ka paraqitur ankim dhe atij që ka lëshuar aktin e ankimuar;
- Propozimin e masave konkrete për rritjen e garancive për procedim disiplinor të prokurorëve duke parashikuar procedura konkrete garantuese që mundësojnë zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, informimin e prokurorit, pjesëmarrjen e tij në proces si dhe ;
- Dhënien e kontributit në miratimin e standardeve të etikës dhe të rregullave të sjelljes së prokurorëve, si dhe për mbikëqyrjen e respektimit të tyre;
- Propozimit për marrjen e të gjitha masave të domosdoshme për krijimin e infrastrukturës ndihmëse në prokuroritë, në mënyrë që të arrihet funksionimi normal i tyre.

<sup>1</sup> Neni 47 Ligji nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë”.

<sup>2</sup> Neni 49 Ligji nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë”.



### **III. Përfundime**

Në përfundim, duke vlerësuar se Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ka një përgjegjësi dhe angazhim të drejtpërdrejtë në organizimin, kontrollin dhe funksionimin e sistemit të prokurorisë, si anëtar i këtij Këshilli, do të angazhohem personalisht nëpërmjet nismave, propozimeve dhe ofrimit të ekspertizës personale për të konkluduar për objektivat dhe standardet që do të duhen arritur dhe ndjekur.

Sfida ime personale do të jetë krijimi i praktikave të mira, transparente dhe të drejta, me qëllim fitimin e besimit të prokurorëve te Këshilli, përmes krijimit të një sistemi meritokratik karriere si dhe përmes propozimit të promovimit të prokurorëve me integritet profesional e moral, e që gjëzojnë besimin e publikut.

Në cilësinë e kandidatit për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nga radhët e prokurorëve të shkallës së parë, duke pasur parasysh problematikat dhe vështirësitë në punën e përditshme të prokurorit të shkallës së parë, qëndrimet e mia do të janë në përkrahje të pavarësisë së prokurorëve, pavarësi që ngarkon secilin prokuror me përgjegjësitë individuale përkatëse.

Me respekt dhe konsideratë të lartë,

**Albert KUMÇI**

**Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë**